



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 277, Datë 13.12.2024

MBI

SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PLANIT DHJETËVJEÇAR TË INVESTIMEVE NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 12 të nenit 16, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; pikës 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2017/5 prot., datë 12.12.2024 të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror “Shtyrjen e vendimarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz Sh.a.”

Konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 293, datë 12.10.2023, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz sh.a.”, ka vendosur nisjen e procedurës për shqyrtimin e “Planit të investimeve dhjetëvjeçar (2023-2032)” të paraqitur nga shoqëria Albgaz sh.a.
- Shoqëria është njoftuar për vendimin nr. 293/2023 me shkresën nr. 2152/5 prot., datë 23.10.2023, ndërsa vendimi është publikuar edhe në faqen zyrtare të ERE-s. Gjithashtu, vendimi është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 157, datë 30.10.2023.
- ERE, me shkresën nr. 2152/6 prot., datë 31.10.2023, i ka kërkuar shoqërisë Albgaz sh.a. të marrë në konsideratë parashtrimet, në përputhje me nenin 11, pika 3, të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me Vendimin të bordit nr. 18, datë 10.01.2018. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Albgaz sh.a., me shkresën nr. 15 prot., datë 16.01.2024, të protokolluar në ERE me shkresën nr. 153 prot., datë 16.01.2024, ka paraqitur një relacion argumentues mbi ecurinë e investimeve për projektet e klasifikuara si me rëndësi strategjike në sektorin e gazit natyror në Shqipëri.

- Për sa më sipër, u vendos organizimi i një seance teknike më datë 23.02.2024 ndërmjet përfaqësuesve të shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe drejtorive teknike të ERE-s, njoftuar me shkresën nr. 152/3 prot., datë 16.02.2024. Gjatë seancës, në zbatim të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit nr. 18, datë 10.01.2018, shoqërisë “Albgaz” sh.a. iu kërkua të paraqesë:
 1. Miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve (2023-2032) nga Këshilli Mbikëqyrës.
 2. Detaje mbi mënyrën dhe burimet e financimit të investimeve.
 3. Informacion mbi bashkëpunimin me KESH sh.a. për projektin e Tubacionit Fier-Vlorë, në përputhje me Gaz Masterplan-in.
 4. Opinionin e Ministrisë së Financave mbi planin e investimeve.
- ERE, me shkresën nr. 2017 prot., datë 30.09.2024, i ka kërkuar Albgaz sh.a. të dorëzojë informacionin dhe dokumentacionin plotësues si më poshtë:
 - Ecurinë e miratimit të planit dhjetëvjeçar të investimeve (2023-2032) nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.
 - Opinionin e Ministrisë së Financave (MF) mbi planin e investimeve, në përputhje me nenin 10, pika 3 të Rregullores për procedurat e miratimit të planeve të investimeve.
 - Detaje mbi mënyrën dhe burimet e financimit të investimeve të planifikuara.
 - Informacion mbi bashkëpunimin me KESH sh.a. për projektin e Tubacionit Fier-Vlorë, sipas Gaz Masterplan-it.
 - Studim fizibiliteti për projektet prioritare të planit të investimeve, në përputhje me nenin 8, pika 6, gërma “e” të Rregullores.
 - Informacion mbi publikimin e planit dhjetëvjeçar dhe opinionet e palëve të interesuara, siç përcaktohet në nenin 6, gërma “f” të Rregullores.
- Në përgjigje të shkresës së ERE nr. 2017 prot., datë 30.09.2024, Albgaz sh.a. me shkresën nr.103/1 datë 24.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 2017/1 prot., datë 28.10.2024, ka informuar për masat e ndërmarra dhe ka kërkuar një shtyrje afati deri në mars 2025 për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes së informacionit të plotë dhe të saktë duke cituar edhe shkresën nr. 132 prot., datë 02.11.2023, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë si organi më i lartë vendimmarrës, me kërkesën për t’iu drejtuar Ministrisë së Financave (MF) me një kërkesë zyrtare për dhënie opinionit në lidhje me planin dhjetëvjeçar të investimeve që shoqëria ka depozituar në ERE për shqyrtim dhe miratim, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Mbi këtë korrespondencë mbetet në pritje të një opinionit nga organet kompetente.
- ERE me shkresën nr.2017/3 prot., datë 02.12.2024, kërkoi nga Albgaz sqarimin se në çfarë faze ndodhet me marrjen e miratimeve të nevojshme, në mënyrë që të vijohet me dorëzimin e të gjithë dokumentacionit konform “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 18, datë 10.01.2018.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, shoqëria “Albgaz” sh.a. me shkresën me nr.103/3 prot., datë 10.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2017/4 prot., datë 02.12.2024, paraqiti kërkesën për shtyrjen e afatit deri në muajin dhjetor të vitit 2025, për përmbushjen e detyrave të kërkuara nga ERE, duke shprehur anagazimin në përditësimin e planit të investimit nga prej saj dhe plotësimin e të gjitha detyrimeve.
- Në pikën 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e vendimeve/qëndrimeve të organeve kompetente si më sipër, është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ERE, vlerësohet që të merret parasysh kërkesa për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përgatitjen e një informacioni të plotë e të saktë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria “Albgaz” sh.a., deri në muajin dhjetor të vitit 2025.
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI